



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 199/ Prot.  
4

Tiranë, më 24.03.2015

VENDIM

Nr. 22, datë 24.3 /2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/Qendra “Res Publica” ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 199 Prot., datë 06.03.2015, ndaj autoritetit publik/Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”. Ankuesi nëpërmjet shkresës datë 07.01.2015, ka kërkuar nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Kopje të regjistrit të protokollit të vitit 2014. Ankuesi pretendon se kërkesa e tij nuk është trajtuar sipas afatit ligjor të përcaktuar në nenin 15/1 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, nga Autoriteti Publik. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në tejkalim të afatit të parashikuar, i ka kthyer përgjigje me shkresën nr.49/1Prot., datë 26.01.2015, duke e informuar kërkuuesin se “është e pamundur vënia në dispozicion e dokumentacionit të kërkuar, pasi rregjistrat e protokollit janë në proces përpunimi për të kaluar në arkivën e Fondit dhe se ky informacion do t’i vihej në dispozicion kërkuuesit në një moment të dytë”.

Komisioneri pas vlerësimit të ankesës së Qendrës “Res Publica”, me Urdhrin nr.36 datë 09.03.2015, urdhëroi kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik/Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Gjatë inspektimit u konstatua se Autoriteti Publik nuk ka vënë në dispozicion të ankuesit dokumentacionin e kërkuar duke e konsideruar informacionin e kërkuar si jo publik, voluminoz dhe se përmban të dhëna personale. Ky fakt është evidentuar në procesverbalin e mbajtur në përfundim të inspektimit, i nënshkruar nga palët prezent.

Më datë 10.03.2015, me shkresën nr.946Prot., Autoritetit Publik/Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, drejtuar Komisionerit, shprehet se “në regjistrin e protokollit figurojnë letërkëmbime me pacientët që i referohen sëmundjeve të tyre ose barnave specifike të cilat përbëjnë të dhëna sensitive dhe mbrohen nga ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar” dhe kërkon mendim nga Zyra e

Komisionerit se si duhet të procedojë në këtë rast.

Komisioneri me shkresën nr. 199/3, datë 24.03.2015 shprehet se dokumentacioni i kërkuar duhet vlerësuar nga Autoriteti Publik në përputhje me nenin 17 të ligjit nr 119/2014 “Për drejtën e informimit” si dhe me nenin 7 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Në rast se Autoriteti Publik vlerëson se informacioni përmban të dhëna sensitive me referencë emër dhe mbiemër të pacientit dhe nëse me të lidhet edhe diagnoza dhe/ose mjekimi përkatës atëherë dokumenti i kërkuar duhet dhënë i anonimizuar.

Në përfundim, në lidhje me ankesën ndaj Autoritetit Publik/Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Komisioneri vlerëson se është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

### **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

### **V E N D O S A:**

1. Pranimin e ankesës së Qendrës “Res Publica”, nr.199Prot., datë 06.03.2015, ndaj Autoritetit Publik/ Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për vënien në dispozicion të dokumentit të kërkuar në përputhje me nenin 17 të ligjit nr 119/2014 “Për drejtën e informimit” si dhe me nenin 7 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar brenda datës 02.04.2015.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ky vendim u dha sot në datë 24.03.2015.

